



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 27.03.2025
Numër Protokolli: 2273/2025

A.nr.192/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.192/2025, të datës 23.01.2025, të parashtruar nga ankuesi B.N, nga Kaçaniku, kundër organit të punësimit/Ministria Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.192/2025, e datës 23.01.2025, e parashtruar nga ankuesi B.N.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i vlerësimit përfundimtar të kandidatëve të suksesshëm, i datës 27.12.2024 i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, B.N (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), me datë 23.01.2025, përmes emailit zyrtar ankesa.kpmshek@rks-org.net, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.192/2025, kundër Njoftimit të datës 27.12.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për shpalljen e rezultateve përfundimtare lidhur me konkursin me numër Reference: RN00015585, për grupin e administrimit të përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën *Zyrtar i Skemave Pensionale*, i shpallur më datë 23.10.2024 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (tutje MFPT), ndërsa kjo e fundit, me datë 04.03.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së krytares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 1506/2025 të datës 07.03.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 503/2025 e parashtruar nga ankuesi më datën 23.01.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Marrëveshjen me numër protokollit 390 të datës 05.11.2020; Marrëveshjen me numër protokollit 301 të datës 09.07.2019; Konkursin me numër reference RN00015585 të datës 23.10.2025; Marrëveshjen me numër protokollit 174 të datës 03.08.2021; Vërtetimin e datës 13.03.2024; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesa për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 04.03.2025; Kërkesën dhe aprovimin për shpalljen e konkursit; Formularët e vlerësimit individual të anëtarëve të komisionit për kandidatën në intervistën e datës 27.12.2024; Testet-estet me shkrim; Vendimin me numër protokollit 3466/2024 të datës 17.12.2024 për themelimin e Komisionit të Pranimit dhe Akt Emërimet e anëtarëve të komisionit të pranimit; Njoftimin për kandidatën fitues të datës 27.12.2024; Lista përfundimtare e vlerësimit; Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Njoftimin e datës 20.12.2024; Listën e aplikantëve; Aplikacionin e ankuesit të datës 13.11.2024 me dokumentacionin e bashkangjitur me rastin e aplikimit; Aplikacioni i kandidatës B.B-T i datës 20.11.2024 me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se MFPT, më datë 23.10.2024 ka shpallur konkursin me numër reference RN00015585, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita *Zyrtar i Skemave Pensionale- Profesional 2*, në Departamentin e Pensioneve, ku afati për aplikim ka qenë nga data 24.10.2024 deri më 22.11.2024, ndërsa sipas shkresave të lëndës, në këtë konkurs kanë aplikuar 71 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesi, dhe sipas njoftimit të datës 20.12.2024 për verifikim paraprak janë përfshirë 47 kandidatë që i kanë plotësuar kushtet e konkursit në mesin e tyre edhe ankuesi, i cili ka marrë pjesë në fazën e vlerësimit të testit me shkrim, nga e cila fazë vlerësimi rezulton se ka arritur gjithsejtë 43.4 pikë, të pa mjaftueshme për të vazhduar tutje me fazën tjetër të rekrutimit.

Pas përfundimit të fazave të vlerësimit, Divizioni i Burimeve Njerëzore i MFPT-së, më datë 27.12.2024, ka publikuar njoftimin për vlerësimin e rezultateve përfundimtare të kandidatëve fitues, nga i cili rezulton se kandidatja B.B-T me gjithsejtë 87.2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi është shpallur kandidatë fituese për pozitën *Zyrtar i Skemave Pensionale, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Trasnfereve*.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 27.12.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të MFPT-së, për shpalljen e kandidatit fitues, pretendon se e njëjta nuk përmbush kriteret e përvojës së punës dhe se në krahasim me të ankuesi posedon 18 muaj përvojë pune në këtë pozitë, duke theksuar ndër të tjera se gjatë zhvillimit të testit me shkrim ka pasur pa rregullsi, ngase i njëjti për rezultatin e testit me shkrim është informuar vetëm 36 minuta pas mbajtjes së tij, duke shtuar po ashtu se disa nga kandidatët kanë përdorur telefonin në testin me shkrim dhe se kandidatja fituese ka pasur qasje paraprakisht në testin me shkrim, ashtu që kërkon anulimin e kësaj procedure rekrutimit.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së pranimit me Nr. reference RN00015585, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita Zyrtar i Skemave Pensionale, në Departamentin e Pensioneve të shpallur nga MFPT, ka konstatuar se për këtë pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor)*. **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës*.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore ju referuar legjislacionit në fuqi, respektivisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë nenit 39 ku përcaktohet se: ... 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidatëve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës”, si dhe dispozitave të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht: **Nenit 9** ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të

kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimi, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimi. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimi e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit, si dhe nenit 10 paragrafi 9 ku përcaktohet se: 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV).

Si rrjedhojë nga analizimi i provave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë Kolegji ka gjetur se vlerësimi i kandidatëve lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është realizuar në mënyrë elektronike, dhe se, pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për gjithë kandidatet, ndërsa nga provat e pranuar nga ankuesi, si dhe organi i punësimit, rrjedh se ankuesi ashtu sikurse kandidatja e përzgjedhur i janë nënshtruar testit me shkrim, mirëpo ankuesi në fazën e testimit me shkrim ka arritur t'i mbledh vetëm 43.4 pikë, nga rrjedh se i njëjti nuk ka arritur t'i marrë pikët e mjaftueshme për të kaluar pragun e kalueshmërisë dhe rrjedhimisht për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht intervistën me gojë, sikurse parashihet me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 9 paragrafi 4 ku përcaktohet se: 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, ashtu që për sa më sipër nuk qëndron pretendimi ankimor i ankuesit se organi përkatës i punësimit gjegjësisht Komisioni i Pranimi në këtë procedurë të rekrutimit nuk ka qenë transparentë dhe korrektë, duke njoftuar ankuesin pas 36 minutave për rezultatin e testit me shkrim, ngase sipas dispozitave ligjore të lartë theksuara, rezulton se nga 26 pyetjet e testit me shkrim, 25 prej tyre vlerësohen nga sistemi elektronik i DMZP/MPB, ndërsa vetëm eseja vlerësohet nga anëtarët e komisionit përkatës, ndërsa afati përfundimtar për vlerësimin e kandidatëve nga testi me shkrim është 10 ditë nga mbajtja e tij.

Tutje, lidhur me pretendimet ankimore se disa nga kandidatët kanë përdorur telefonin në testin me shkrim dhe se kandidatja fituese ka pasur qasje paraprakisht në testin me shkrim, Kolegji i Këshillit konstaton se këto pretendime ankuesi nuk i ka mbështetur me ndonjë dëshmi apo provë konkrete që do të rezultonte me vërtetimin e tyre mirëpo vetëm mbi supozimet e tij, si rrjedhojë të njëjtat janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara, si dhe duke shtuar faktin se procesi i vlerësimit të testit me shkrim monitorohet edhe nga DMZP/MPB dhe jo vetëm nga Komisioni i Pranimit, sikurse edhe pretendimi tjetër ankimor i ankuesit se në krahasim me kandidaten e përzgjedhur posedon përvojë pune relevante në këtë pozitë prej 18 muajsh është i pa bazuar, ngase duke qenë se i njëjti plotëson kërkesat e përgjithshme formale të konkursit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë sepse siç është theksuar edhe më sipër i njëjti ka marrë pjesë në vlerësimin e kandidatëve, mirëpo si rezultat i vet përgjigjeve të tij nuk ka arritur të kalojë në fazën e vlerësimit përfundimtar atë të intervistës me gojë, rrjedhimisht i njëjti sikurse edhe gjdo kandidat që plotëson kriteret përkatëse të konkursit, për tu shpallur kandidat fitues duhet ti nënshtrohet të gjitha fazave të vlerësimit dhe në bazë renditjes përfundimtare mund të shpallet kandidat fitues.

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor se kandidatja fituese B.B-T, nuk plotëson përvojën e punës, Kolegji nga analizimi i aplikacionit të saj të datës 20.11.2024, ka gjetur se e njëjta ka bashkangjitur Diplomën e datës 22.02.2022 me numër 1565, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, përmes së cilës dëshmohet se e njëjta me datë 19.01.2022 ka mbaruar studimet themelore/Bachelor në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë; Kontratën e punës së datës 01.01.2022 të lëshuar nga Pro Consultin and Trading Sh.P.K si dhe Vërtetimin e datës 01.10.2024, përmes së cilave dokumente dëshmohet fakti se e njëjta nga data 01.01.2022 e deri me datë 31.12.2023, ka mbajtur pozitën Koordinatore për mbikëqyrjen e cilësisë dhe standardeve në menaxhim në të njëjtën kompani, sikurse të njëjtën përvojë të punës e mbështet edhe me pasqyrën e llogarisë të lëshuar nga Trusti/Fondi i Kursimeve Pensionale, rrjedhimisht Kolegji konstaton se kandidatja në fjalë ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të konkursit, ngase posedon Diplomën e lartë e arsimit të nivelit të lartë të parë (Bachelor) dhe po ashtu e njëjta ka dëshmuar se posedon më shumë se një (1) vit pune profesionale pas studimeve themelore, ashtu që e njëjta ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit të kandidatëve, duke kaluar me sukses testin me shkrim (59 pikë) dhe intervistën me gojë (28.2 pikë) duke mbledhur kështu gjithsejtë 87.2 pikë të përgjithshme nga kjo procedurë rekrutimi, dhe si rrjedhojë e njëjta ka fituar të drejtën për emërim në shërbimin civil, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.*

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni i Pranimit dhe rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse të punës ashtu sikurse edhe shpalljen e Njoftimit të datës 27.12.2024 për kandidatin fitues për pozitën e punës

Zyrtar i Skemave Pensionale-Kaçanik, me numër reference RN00015585, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.192/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.N;
- Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.